



USAID
FROM THE AMERICAN PEOPLE

ALBANIA

PRESS RELEASE

Sistemet e reja përmirësojnë shërbimet publike në Fushë-Krujë

FUSHË-KRUJË, 17 DHJETOR, 2009 Me mbështetjen e Programit të USAID-it për Qeverisjen Vendore (LGPA), Fushë-Kruja përruroi sot një sistem të ri të kompjuterizuar të taksave vendore dhe zyrën e kompjuterizuar të informimit publik. Sistemet e reja do t'i ofrojnë publikut akses më të madh tek informacioni si dhe një mjedis miqësor.

Drejtorja e Taksave e Fushë-Krujës, ashtu si shumë bashki të tjera, duhej të bënte pjesën më të madhe të punës me dorë. Me sistemin e ri të kompjuterizuar, drejtorja e taksave do të jetë në gjendje të llogarisë më saktë taksat si dhe të evidentojë pagesën e tyre, madje edhe të hartojë parashikimet dhe analizat e duhura të të ardhurave kaq të rëndësishme për hartuesit e planeve dhe zyrtarët. Kompjuterizimi i sistemit të taksave do të ndihmojë bashkinë të përmirësojë vjeljen e taksave si dhe rritjen e të ardhurave prej tyre, kështu që Fushë-Kruja të jetë në gjendje të ofrojë shërbime më cilësore për qytetarët e saj. Kjo mënyrë do të ulë edhe numrin e ndërveprimeve një-për-një me punonjësit e tatimeve, që citohen si burim i praktikave korruptive. Sistemi i ri i kompjuterizuar i taksave do të rrisë monitorimin dhe vlerësimin si dhe do të ulë gabimet me dorë.

Zyra e re e Informimit Publik ofron një "zyrë me një ndalesë" të thjeshtë dhe të përshtatshme ku qytetarët dhe bizneset do të marrin asistencë efikase dhe profesionale në një sërë çështjes duke filluar që nga informacioni i përdituar për ligjet, procedurat dhe deri tek investimet dhe mundësitë për biznes në këtë qytet. Zyra u ngrit me ndihmën e organizatës jo-fitimprurëse ASET, me një grant nga Programi LGPA.

Mbështetja teknike dhe materiale e USAID/LGPA për Drejtorinë e Taksave të Fushë-Krujës dhe për Zyrën e Informimit Publik arrin në total mbi 4,045,000 Lekë.

Programi i Qeverisjes Vendore në Shqipëri (LGPA) i USAID punon me bashki partnere në të gjithë Shqipërinë me qëllim që të mbështesë zhvillimin e ekonomisë vendore, të përmirësojë qeverisjen dhe të forcojë pjesëmarrjen e shoqërisë civile dhe sektorit privat në zhvillimin vendor. Bashkitë partnere të LGPA janë Fieri, Fushë Kruja, Gramshi, Korça, Kukësi, Lezha, Librazhdi, Pogradeci, dhe Shkodra.

###